



UDHËZUES PËR DALJEN E KONSUMATORËVE NË TREGUN E LIRË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Nga Qershori 2025, të gjithë **ndërmarrjet ekonomike** në Kosovë do të obligohen të zgjedhin **vetë furnizuesin e tyre të energjisë elektrike** në tregun e lirë. Ky udhëzues ju ndihmon të kuptoni procesin, të drejtat tuaja dhe hapat për një kalim të suksesshëm në treg të lirë.

Hapat	Veprimet
Kriteret ligjore për kalim të detyrueshëm	Obligimi për dalje në tregun e lirë vlen për të gjithë ndërmarrjet ekonomike që përmbushin njërin nga kriteret: <ul style="list-style-type: none">Qarkullim vjetor mbi 10 milion euro, oseMë shumë se 50 të punësuar.
Mbledhja e të dhënave të konsumit	<ul style="list-style-type: none">Mblidhni të dhënat e konsumit të energjisë për 12 muajt e fundit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS).Të dhënat janë të qarta, të kuptueshme dhe mbrohen sipas ligjit për privatësinë.
Analiza e konsumit dhe hulumtimi i tregut	<ul style="list-style-type: none">Analizoni profilin tuaj të konsumit dhe hulumtoni tregun e energjisë sipas kërkesës tuaj.Përdorni këto të dhëna për të kërkuar dhe krahasuar ofertat nga furnizuesit.
Identifikimi i furnizuesve të energjisë	<ul style="list-style-type: none">Zgjidhni vetëm furnizues të licencuar nga ZRRE ⇒ Lista e furnizuesve të licencuar – ZRREKontaktoni furnizuesit për të marrë oferta të detajuara.
Krahasimi i ofertave	Çka duhet të krahasoni para zgjedhjes së ofertës: <ul style="list-style-type: none">Çmimet: fikse ose të ndryshueshmeKushtet e kontratësCilësia e shërbimit ndaj konsumatorit
Hapat e përgjithshëm të kalimit në tregun e lirë për konsumatorin	<ol style="list-style-type: none">Kërkesa për ndërrim - Dorëzoni dokumentacionin te furnizuesi i ri.Nënshkrimi i kontratës së re - Lexoni me kujdes, kuptoni detyrimet, dhe nënshkruani.Njoftimi i furnizuesit aktual - Njoftoni për ndërprerje sipas kushteve të kontratës.Verifikimi i faturave - Kryeni të gjitha pagesat ndaj furnizuesit aktual.Fillimi i furnizimit të ri - Përcaktohet data e fillimit me furnizuesin e ri – në koordinim me operatorin e sistemit.Furnizim pa ndërprerje - Kalimi bëhet teknikisht, pa ndërprerje të energjisë.Faturimi i ri - Do të merrni fatura të reja sipas kontratës së re.
Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF)	Konsumatorët që nuk zgjedhin furnizues do të kalojnë automatikisht te FMF për një periudhë 60-ditore . Gjatë kësaj kohe, çmimet do të jenë më të larta sesa ato në treg.
Këshilla shtesë	<ul style="list-style-type: none">Kalimi në tregun e lirë kërkon kujdes dhe planifikim.Mos e lini zgjedhjen e furnizuesit për momentin e fundit.